



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 633 prot

Roskovec, më 31.01.2024

VENDIM

NR 5 .DATE 30.01.2024

"PËR MIRATIM TË PROJEKTEVE PRIORITARE PËR BASHKINË ROSKOVEC "

Mbështetur në autoritetin e Kryetarit të Bashkisë Roskovec dhe në zbatim të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, neni 29,
Në zbatim të nenit 16, të Ligjit Nr. 8756, dt. 26.03.2001, "Për Emergjencat civile", ligjin Nr.107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar neni 12 dhe neni 13, dhe VKM Nr. 686, datë 22.11.2017, "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit", Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

1. Miratimin e projekteve prioritare të cilat kanë nevojë për ndërhyrje emergjente.

Pas kontrolleve në terren të grupit teknik të Bashkisë Roskovec dhe ekspertëve të jashtëm në periudha të ndryshme të vitit si dhe nga eksperiencat e mëparshme të fatkeqësive natyrore, projektet në zonat e mëposhtme kanë nevojë emergjente për ndërhyrje, për realizim projekti, për financim apo për zbatim projekti.

Projekte Infrastruktura:

- 1- **Ndërtimi i unazës Perëndimore (e cila ka 3 nënobjekte)**
 - Ndërtimi i tregut agro-ushqimor
 - Terminali i autobusave ndërqytetas
 - Rrugët lidhëse
- 2- **Marrja e masave për transferimin e banorëve të zonës së shkarjes Mbërs.**
- 3- **Rritja e sigurisë së argjenaturës përgjatë "lumit Seman"**
- 4- **Rehabilitimi Urban i një pjese të bllokut nr. 3 në qendër të qytetit Roskovec, (faza I), me këto nënobjekte:**
 - Ndërtimi i fushës së sportit me njësi tregëtare
 - Ndërtimi i parkut të ri të qytetit

- Sistemimi i kanalit kullues dhe ndërtimi i rrugës lidhëse mbi të
 - Ndërtimi i Postës së re të Policisë (Projekt ekzistues i miratuar nga Bashkia Roskovec)
 - 5- Rikonstruksioni i ujësjellësit të Njësisë Administrative Kuman
 - 6- Ndërtim i ujësjellësit të fshatit Ngjeqar, Njësia Administrative Kurjan.
 - 7- Rikualifikim urban i qendrave të fshatrave.
 - 8- Sistemi fotovoltaik për vetkonsum në stacionet e pompimit Arapaj, Metushaj, Jagodinë.
 - 9- Sistem fotovoltaik për ngrohje në godinat e arsimit parauniversitar.
 - 10- Rijetëzim i ambjentëve sportive në territorin e Bashkisë Roskovec.
 - 11- Linjë përpunimi të perimeve të fushës dhe përpunim i produktit ndryshe.
 - 12- Rritja e sigurisë së digës dhe përmirësimi i ujitjes në rezervuarin e Kurjanit.
 - 13- Përmirësimi i ujitjes në fshatin Suk 1,
 - 14- Rehabilitimi i përroit të Vidhishtës (përgjatë fshatit),
 - 15- Njësi përpunimi, grumbullimi, laborator dhe markimi i vajit të ullirit.
 - 16- Linja e përpunimit të produktit ndryshe
 - 17- Rivitalizimi i pyllit të Luarit dhe parkut rekreativ
 - 18- Krijimi i shtegut të bicikletave
 - 19- Rikonstruksioni total i kishës së Shën Gjergjit (Monument kulture)
 - 20- Pyllëzimin e liqenit të Kurjanit
 - 21- Pyllëzimi i brezit të gjelbër, Suk-Jagodinë- Marinëz.
 - 22- Krijimi i parkut zero karbon.
- Ngarkohet Drejtorja e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit me zbatimin e këtij vendimi.
 - Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

